



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920179

Datë: 27.09.2021

Numri i dokumentit: 02212685

Ae.nr.250/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit [“O...”], sh.p.k., me seli në Ferizaj, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [S.K.], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës “Komuna e Vushtrisë”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ismet Gashi, për shkak të kompensimit të dëmit, në shumën e përgjithshme prej 27,549.60€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.Ek.nr.590/2016, të datës 30.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës, “Komuna e Vushtrisë”, me seli në Vushtri, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.Ek.nr.590/2016, të datës 30.04.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit [“O...”], shp.k., me seli në Ferizaj, ashtu që është detyruar i padituri “Komuna e Vushtrisë”, që t’ia paguaj paditësit shumën prej 27,549.60€, në emër të kompensimit të borxhit nga kontrata me furnizim me bletë, me kamatë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, dt.20.12.2016 e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar i padituri që

paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,321.00€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Komuna e Vushtrrisë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës në tërësi si e bazuar, të prishet Aktgjykimi I.EK.nr.590/16 në tërësi si të pabazuar dhe çështjen ta vendosë në mënyrë meritore konform dispozitave ligjore ose secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

Përgjigje në ankesë nuk ka

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhe se paditësi ["O..."], shp.k., me seli në Ferizaj, me datën 20.12.2016, pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi për kompensimin e borxhit kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë. Nder të tjera në padi ka pretenduar se me datën 14.05.2015 paditësi dhe i padituri kane lidhur kontrate për furnizim me blete, destinimi i të cilave ishte shpërndarja si donacion për disa fermer të Komunës së Vushtrrisë. Paditësi ka pasur një vonese në furnizimin me bletë e cila ka qenë e arsyeshme dhe në interesin e të paditurit dhe përfituesve të bletëve nga se vonesa ka ndodhur për shkak së paditësi ka dashur që të bëjë kontrollin e bletëve lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore. Pas përfundimit të ekzaminimeve shëndetësore dhe pajisjeve me certifikatë se bletët nuk kanë ndonjë sëmundje paditësi ka bërë liferimin e bletëve. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të obligohet e paditura Komuna e Vushtrrisë që paditësit ["O..."], me seli në Ferizaj në emër të borxhit të papaguar në bazë të kontratës për furnizim me shoqëri bletësh në Komunën e Vushtrrisë t'ia paguaje për shkak të mos përmbushjes së kontratës shumën prej 27,549.60€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se paditësi dhe i padituri kanë qenë në raport juridik detyrimore përmes lidhjes së kontratës publike të datës 14.05.2015 me titullin "F..." ku sipas kontratës pala paditëse ka marrë detyrimin e liferimit të 312 koshereve me bletë, me disa pajisje shtesë dhe ushqime rezerve për bletë, ndërsa i padituri ka marrë detyrimin e pagesës së çmimit blerëse në shumën prej 27,549.60€. Paditësi e ka bërë furnizimin me mallin e kontraktuar ashtu që më datën 08.08.2015 i ka dërguar të gjitha kosheret dhe pajisjet sipas kontratës në lokacionin e përcaktuar nga pala paditëse në periferi të qytetit të Vushtrrisë në lokacionin e ashtu quajtur "te vreshtat". Paditësi ka pasur vonesë në liferimin e mallit por ka dhënë disa arsye tek Komuna se autoriteti kontraktues dhe ajo ia ka mundur vazhdimin e periudhës së garancionit dhe përmbushjen e kontratës, kështu e paditura e ka caktuar menaxherin e kontratës dhe e ka formuar komisionin për pranimin e mallit i cili mall është pranuar në dorëzim në lokacionin "tek vreshtat në Vushtrri. Ishte jo kontestuese se kosheret me

bletë janë kontrolluar dhe janë përcjellur në mënyrë vizuale nga i padituri dhe nga inspektorët nga AUVK gjatë kohës sa ishin të vendosura në lokacionin “tek vreshtat”, nuk është vërejtur ndonjë problem apo parregullsi tek kosheret me bletë, derisa ishin të vendosura në atë lokacion ku bletët kanë qëndruar në atë lokacion nga data 08.08.2015 deri më datën 15.08.2015 datë kjo kur palët në kontratë e kanë bërë shpërndarjen e koshereve tek palët e treta familjes përfituese të donacionit si dhe nuk është regjistruar ndonjë pengese apo parregullsi lidhur me procesin e shpërndarjes së bletëve tek familjet përfituese.

Menjëherë pas shpërndarjes së bletëve kanë filluar dyshimet në mesin e përfituesve dhe zyrtareve komunal të angazhuar në këtë projekt lidhur me atë se bletët janë të infektuar me ndonjë sëmundje, ku i padituri menjëherë ka informuar për këto dyshime palën paditës si furnizues dhe A...-në, ku me këtë raste ka pasur vizita të A...-së tek disa koshere të shpërndara ku janë hapur kosheret dhe janë kontrolluar në mënyrë të detajuar. Tek kosheret e dorëzuara tek F.H nga fshati ... janë marrë mostra ku pas ekzaminimit laboratorik ka rezultuar një mostër më prezencën e sëmundjes së Murtajës Amerikane, pas disa ditësh edhe tek dy përfituesit e tjerë janë marrë mostra dhe tek S.A nga fshati ... dhe tek F.M nga fshati ... nga katër mostrat që janë ekzaminuar dy prej tyre kanë rezultuar si pozitive me prezencën e sëmundjes së murtajës amerikane, ndërsa dy teste tjera kanë dalë negativ. Pas këtij rezultati AUVK ka marrë vendim që të asgjësohen shoqëritë e bletëve në lokacionet ku ishin nxjerrë mostrat tek tre përfitues e që ishin gjithsej 12 shoqëri bletësh vendimi i datës 16.09.2015. Pas kësaj gjendje serioze dhe dyshimeve tjera lidhur me kosheret e pa ekzaminuara A... ka rekomanduar që të gjitha kosheret e liferuara dhe tanimë të shpërndara tek përfituesit të mbyllën dhe të dërgohen në një lokacion me të izoluar për të parë se cilët do të jene hapet e mëtejshëm. E paditura e ka njoftuar paditësin me rekomandimet e dhëna nga A... dhe e ka njoftuar atë që të grumbulloje kosheret me bletë në një destinacion më të izoluar, me ç'rast paditësi i ka shkruar një emali të paditurit ku ka theksuar se në kemi bërë dorëzimin e koshereve me bletë dhe pajisjeve përcjellëse konform nenit 21.3 të kushteve të veçanta të kontratës nuk është në kompetence tonë që të merremi me grumbullimin e koshereve që i kemi shpërndarë para 17 ditësh, nuk kemi pranuar asnjë shkresë apo njoftim nga A... dhe se është në kompetencën e institucionit për të bërë trajtimin e duhur. Po ashtu ishe jokontestuese se i padituri ka organizua mbyllën e të gjitha koshereve të liferuara dhe e ka ftuar paditësin që të bëjë grumbullimin e tyre, paditësi i ka shkruar përsëri emal palës së paditur ku ka shprehur shqetësimin e tij se furnizimi me bletë ka qenë i rregullt dhe se nuk do të bëjë grumbullimin e koshereve. Pas krijimit të kësaj situatë i padituri e ka organizuar grumbullimin e bletëve duke e dërguar atë në një zonë me të izoluar në bjeshkën e Qyqavicës ku i ka mbajtur kosheret të mbyllura për disa ditë me radhe. Derisa bletët ishin në atë gjendje të izolimit total, A... ka marrë vendim që të gjitha kosheret e grumbulluara 281 copë të asgjësohen, ky vendim është marrë me datën 29.09.2015 në vendim janë përmendur disa arsye vendimtare për asgjësim si dyshimi se bletët janë të infektuara me sëmundjen e murtajës amerikane, mosbashkëpunimi i firmës furnizuese dhe Komunës për të menaxhuar situatën, gjendja e dobët e shoqërive të bletëve dhe se shoqëritë janë të vogla me pak miza të cilat edhe nëse janë të sëmura nuk mund ti rezistojnë të ftohtit dimëror. Vendimi është ekzekutuar nga A... ashtu që janë asgjësuar 281 plus 12 shoqëri me blete të liferuara se bashku me kosheret dhe hojet që kishin. Pjesa tjetër e shoqërive m blete të liferuara prej 19 copë nuk ka pasur të dhëna gjatë

gjykimin se kanë mbetur dhe sipas të gjitha gjasave kanë mbetur të shpërndara në terren, pasi asnjëra palë nuk ka provuar me prova konkrete lidhur me fatin e tyre. Po ashtu nuk ka dhënë se çfarë ka ndodhur me pajisjet e tjera përcjellëse si ushqimi rezerve, uniforma e disa pajisje të tjera, përveç disa fotografive në shkresat e lëndës ku pajisjet shihet së janë hedhur nëpër tokë. Ku në fund i padituri ka marrë vendim për shkëputjen e kontratës dhe ka refuzuar pagesën e shumës së kontraktuar me arsyetimin së paditësi ka dështuar në përmbushjen e kontratës në mënyrë të rregullt. Andaj, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës së parë në shumë prej 27,549.60€, në emër të kompensimit të borxhit nga kontrata me furnizim me bletë.

Prandaj, mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 17 par.1, 262 par.1 të LMD-së, si dhe dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit duke u mbështetura në Dispozitat e nenit 15 dhe 17 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, parashohin se palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të obliguara t i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre. Ndërsa sipas Nenit të 262 LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos-përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e ligjit material sepse sipas dispozitës së Nenit 17 para.1 të LMD-së përcaktohet se “*pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre*”. Ndërsa në dispozitën e nenit 262 par.2 të LMD-së është përcaktuar se “*kreditori në raport detyrimor është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit është përgjegjës ta përmbushë detyrimin e tij në mënyrë të ndërgjegjshme*”.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është krijuar detyrimi i të paditurës që ta paguaj çmimin blerës në shumën prej 27,549.60€, për shkaqet në vijim:

Me dispozitën e Nenit 438 të LMD-së, përcaktohet se “*me kontratën e shitjes detyrohet shitësi që sendin të cilin e shet t'ia dorëzojë blerësit dhe t'ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin*”. Në rastin konkret janë përmbushur detyrimet kontraktuese të palëve pasi nuk është kontestuese se paditësi ja ka dorëzuar të paditurës sendet e kontraktuara ndërsa paditura i ka pranuar bletët në dorëzim, i ka mabjtur ato për disa ditë në lokacion “tek vreshtat” në Vushtrri, e ka emruar menaxherin e kontrates, e ka themeluar Komisionin për Pranimin e Bleteve dhe ka bërë

shpërndarjen e koshereve me bletë tek perfituesit, respektivisht ka bërë pranimin e rregullte po nuk e ka paguar çmimin kontraktues.

Pretendimet e të paditurës për dorëzimin jo të rregullte të mallit janë të pabazuara në ligj sepse me dispozitën e Nenit 461 të LMD-së, ne paragrafin 1 dhe 2 përcaktohet se: *“Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut në blerësin, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit. 2. Shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut në blerësin, në qoftë se janë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë”*. Ndërsa me dispozitat e Nenit 464 përcaktohet se: *“blerësi ka për detyrë që sendin e pranuar ta shikojë ose ta japë në shikim sapo kjo të jetë e mundur sipas rrjedhës së rregullt të gjërave dhe për të metat e dukshme ta lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh, ndërsa te kontratat midis ndërmarrësve pa shtyrje përndryshe e humb të drejtën që i takon mbi këtë bazë. 2. Kur kontrollimi të jetë bërë në prani të të dy palëve, blerësi është i detyruar që vërejtjet e veta për të metat e dukshme t’ia komunikojë shitësit menjëherë, përndryshe e humb të drejtën e cila i takon mbi këtë bazë”*.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se: paditësi e ka bërë furnizimin me mallin e kontraktuar ashtu që më datën 08.08.2015 i ka dërguar të gjitha kosheret dhe pajisjet sipas kontratës në lokacionin e përcaktuar nga pala paditëse në periferi të qytetit të Vushtrisë në lokacionin e ashtu quajtur “te vreshtat”. E paditura e ka caktuar menaxherin e kontratës dhe e ka formuar komisionin për pranimin e mallit i cili mall është pranuar në dorëzim në lokacionin “tek vreshtat në Vushtri. Kosheret me bletë janë kontrolluar dhe janë përcjellur në mënyrë vizuale nga i padituri dhe nga inspektorët nga A... gjatë kohës sa ishin të vendosura në lokacionin “tek vreshtat”, dhe nuk është dhënë ndonjë vërejtje nga ana e të paditurës lidhur me ndonjë problem apo parregullsi tek kosheret me bletë. Derisa ishin të vendosura në atë lokacion ku bletët kanë qëndruar nga data 08.08.2015 deri më datën 15.08.2015 datë kjo kur palët në kontratë e kanë bërë shpërndarjen e koshereve tek palët e treta familjes përfituese të donacionit dhe nuk është regjistruar ndonjë pengese apo parregullsi lidhur me procesin e shpërndarjes së bletëve tek familjet përfituese.

Bazuar në dispozitat e sipërcekura dhe mbi gjendjen e konstatuar faktike rezulton se pranim-dorëzimi i bletëve është bërë në mënyrën e paraparë me kontratë dhe në përputhje me dispozitat ligjore, sepse e paditura e ka pranuar mallin në mënyrë të rregullte, ka bërë kontrollimin e mallit dhe nuk ka dhënë asnjë vërejtje në cilësi apo sasi as me rastin e pranimit, e as brenda periudhës 8 ditore të përcaktuar me ligj. Prandaj rreziku lidhur me bletët e pranuar ka kaluar te e paditura dhe ajo mban përgjegjësinë për mallin e pranuar, pasi e ka pasur përgjegjësinë që të njëjtin ta kontrollojë në momentin e pranimit ndërsa nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për ta vërtetuar se dëmtimi ka qenë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë respektivisht se bletët kanë qenë të infektuara në momentin e dorëzimit.

Poashtu Gjykata e Apelit ka gjetur se shkëputja e kontratës është bërë në kundërshtim me ligjin, sepse edhe po të ekzistonin të metat e mallit në momentin e dorëzimit të bletëve, sipas dispozitës së Nenit 471 të LMD-së, e paditura ka mundur të kërkojë nga shitësi që të metën ta mënjanojë, ose t’ia dorëzojë sendin tjetër pa të meta (përbushja e kontratës) apo të kërkojë zbritjen e çmimit dhe vetëm pas konsumimit të këtyre dy mundësive të deklarojë zgjidhjen e kontratës, e jo ashtu siç ka vepruar ne rastin konkret e paditura.

Mbi këtë bazë janë të paqëndrueshme edhe pretendimet ankimore lidhur me shkëputjen e kontratës për shkak të mospërmbushjes së obligimit kontraktues brenda afatit të përcaktuar me kontratë sepse sipas dispozitave të Nenit 106, Nenit 112 dhe Nenit 113 Nenit të LMD-së, parashihet se, njëra palë kontraktuese fiton të drejtën e ndërprejtes së njëanshme të kontratës për mos përmbushje, vetëm nëse pala tjetër kontraktuese, me fajin e tij, të mos e përmbush detyrimin e tij brenda afatit shtesë, që kreditori ta ketë njoftuar debitorin për përfundimin e kontratës dhe që shkëputja e kontratës mos të bëhet për shkak të mospërmbushjes së pjesës së parëndësishme të detyrimit. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rrjedh se e paditura konform këtyre dispozitave i ka kërkuar paditësit vazhdimin e Policës së sigurimit deri me datë 12.09.2015, të cilën paditësi e ka siguruar. Poashtu e paditura i ka dhënë paditësit afat shtesë për dorëzimin e bletëve dhe të njëjta i ka pranuar me datë 08.08.2015, andaj me pranimin e mallit humbet e drejta për shkëputje të kontratës për shkak të mospërmbushjes brenda afatit kontraktues

Në rastin konkret në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara si dhe me dispozitat e Nenit 28.1 pikat a) dhe b) të kontratës, e paditura njëanshëm, pa paralëjmërim, respektivisht pa kërkuar përmbushjen e kontratës, e ka shkëputur kontratën pas pranimin të mallit. Kjo nga shkakut se te kontrata kontesuese, pavarësisht përcaktimit të afatit për dorëzimin e mallrave, megjithatë nuk kemi të bëjmë me kontratë me *afat* në të cilën afati përbën element thelbësor të kontratës (*essentia negotii*). Kontratë me afat është një kontratë në të cilën palët kontraktuese pajtohen që kontrata duhet të përmbushet brenda një kohe të rreptë (fikse), përndryshe kontrata do të përfundojë sepse humbet qëllimi për të cilën është lidhur kontrata. Në rastin konkret palët, me nenin 1.5 të kontratës kanë parapare penalitetet 0,25% në ditë, deri në shumën prej 10% të vlerës së furnizimeve të padorëzuar dhe vetëm pas kësaj ka pasur të drejtë ta shkëpusë kontratën, por askund nuk kanë përcaktuar se mos-dorëzimi i mallit në datën dhe vendin e caktuar nënkupton shkëputjen automatike të kontratës. Edhe nëse analizohet përmbajtja e kontratës rezulton qartë se për nga natyra kontrata nuk përbën kontratë ku afati është element thelbësor sepse objekti i kontratës ka qenë furnizimi me bletë, e jo përmbushja në afatin e caktuar sepse vonesa nuk e ndryshon qëllimin e kontratës dhe as nuk e humb interesin e kreditorit për furnizim me mallrat e kontraktuara ndërsa të kontratat me afat mos përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar, për nga natyra e punës së kontraktuar, humbet edhe qëllimi po edhe interesi i kreditorit për përmbushjen e detyrimit. Parimisht, në kontratën e shitjes, elementët thelbësorë janë vetëm objekti dhe çmimi, ndërsa afati nuk është një element thelbësor i kësaj kontrate. Nëse kontraktuesit dëshirojnë që afati i pagesës të jetë element thelbësor, atëherë ata duhet ta kontraktojnë atë si të tillë.

Këtë qëndrim gjykata e mbështet edhe në dispozitat e Nenit 85 të LMD-së, i cili në par.2 përcakton se: *“Me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese nuk duhet lidhur vetëm për domethënien tekstuale të shprehjeve të përdorura, por duhet hulumtuar qëllimi i përbashkët i kontraktuesve dhe dispozita të kuptohet ashtu sikundër u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj”*. Ndërsa Neni 86 parasheh se: *„në rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër*. Në rastin konkret e paditura e ka përpiluar kontratën dhe

ka përcaktur kushte të paqarta andaj kontrata duhet të interpretohet në favor të paditësit respektivisht në favor të objektit thelbësor kontraktues, duke i lënë anash specifikat kontradiktore.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të së paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr. 250/2019 data 09.09.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutull, d.v.

